

URDHËR
Nr. 38/1, datë 10.12.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 38, DATË 28.1.2014 “PËR DELEGIMIN
DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË PUNËVE
TË BRENDSHME”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 27 dhe neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 38,d atë 28.1.2014, të bëhet ky ndryshim:

1. Pika 5 ndryshon si vijon:

“5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit, si dhe të drejtën për të hartuar, dorëzuar dhe nënshkruar kërkesëpadi.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri